



**"AlbAudit" Sh.P.K.**

**Shoqata e të Verbërve të Kosovës  
(SH.V.K.)**

**Prishtinë**

**Raport i Auditorit te Pavarur**

**Pasqyrat Financiare**

**31 Dhjetor 2023**

## P Ë R M B A J T J A

	Faqja
Raport i Auditorit të Pavarur.....	2-3
Informatat e përgjithshme.....	4
Pasqyrat financiare.....	5-6
Misioni i OJQ Shqata e të Verbërve të Kosovës.....	7
Politkat kontabel.....	7-9
Projektet e OJQ dhe shërbimet e ofruara gjatë vitit 2023.....	9-10
Projektet, Pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e OJQ-se, përfundimi.....	11-14

# RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

## Menaxhmentit të OJQ-së, "Shoqata e të Verbërve të Kosovës"

### Opinionit i auditorit

Gjatë kryerjes së punës së auditimit kemi ardhur në përfundim se pasqyrat financiare janë të liruara nga keq pohimet eventuale materiale.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat shoqëruese paraqesin një pamje të vërtetë dhe të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, të pozicioneve financiare të organizatës joqeveritare "Shoqata e të Verbërve të Kosovës", të dispozitave ligjore, udhëzimeve, procedurave dhe rregullave në fuqi për periudhën e cila përfundon më 31.12.2023, si dhe rezultatet e operimeve të saj në pajtueshmëri me principet e kontabilitetit të cilat janë të aplikueshme në Kosovë.

### Baza për dhënje të opinionit

Politikat e OJQ "Shoqata e të Verbërve të Kosovës" janë në përputhje me dispozitat e ligjit Nr.06/L- 43, për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare. Në këtë bazë të ardhurat njihen atëherë kur ndodhin gjegjësisht pranohen, dhe shpenzimet gjithashtu kur ato ndodhin në përputhje me standardet e kontabilitetit të cilat zbatohen në Kosovë. Në pasqyrat financiare të kësaj periudhe, parimi kohor dhe joprofitabil është realizuar plotësisht duke njohur të ardhurat për projekte vetëm për shpenzimet e ndodhura, ndërsa tepricat duke mbajtur në gjendje detyrimi sipas projekteve.

Në saje të natyrës së shënimeve të shfrytëzuara gjatë auditimit, si dhe asistencës së zyrtarëve të angazhuar në punët llogaritare dhe të menaxhimit të OJQ-së, ne kemi arritur që të kemi një siguri të arsyeshme lidhur me saktësinë dhe kompletimin e shënimeve lidhur me mjetet financiare të pranuar nga zyrtarët e OJQ-së, si dhe menaxhimin dhe shpenzimin e tyre në harmoni me ligj. Procedurat e hartuara të cilat i aplikon "Shoqata e të Verbërve të Kosovës" gjatë kryerjes së operimeve të saj janë në harmoni me ligje dhe rregullore të cilat aplikohen në Kosovë.

### Çështjet Kryesore të Auditimit

Auditimi përfshinë ekzaminimin në bazë të testeve të dhënave në mbështetje të shifrave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori konsideron të përshtatshëm kontrollin e brendshëm për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, dhe arsyeshmërinë e politikave të përdorura si dhe nevojën e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, gjithashtu edhe prezantimin e përgjithshëm të pasqyrave financiare. Ne besojme se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

## **Përgjegjësia e drejtimit të organizatës për pasqyrat financiare**

Për këto pasqyra financiare përgjegjëse është udhëheqja e organizatës joqeveritare, “Shoqata e të Verbërve të Kosovës”. Menaxhmenti është përgjegjës për prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare. Kjo përgjegjësi përfshinë krijimin, realizimin dhe ruajtjen e kontrollit të brendshëm relevant për pregaditjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të liruara nga gabimet dhe mashtrimet e mundshme; përzgjedhja dhe ndryshimi si dhe realizimi i politikave të përshtatshme kontabël, si dhe krijimi i vlerësimeve të arsyeshme kontabël në rrethana të paraqitura.

## **Përgjegjësia e auditorit**

Përgjegjësia jonë është të japim mendimin për pasqyra duke u mbështetur në auditimin e bërë.

Përpos asaj që diskutohet në paragrafin në vijim, ne kemi kryer auditimin në përputhje me standardet e auditimit, të cilat aplikohen në Kosovë. Këto standarde kërkojnë të veprojmë në përputhje me kërkesat etike dhe auditimin ta planifikojmë dhe kryejmë me qëllim të arritjes së bindjes mbi atë se a janë pasqyrat financiare të liruara nga tregues të gabueshëm. Zgjedhja e veprimeve të caktuara mvaret nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut të treguesve të rëndësishëm të gabuar financiar përmes gabimeve dhe mashtrimeve. Me rastin e vlerësimit të atij rreziku, auditori shqyrton kontrollat e brendshme të rëndësishme për prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare me qëllim të formulimit të veprimeve audituese të përshtatshme për rrethana të caktuara, por jo edhe për shprehje të mendimit mbi suksesin e kontrolleve të brendshme të subjektit të audituar. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e parimeve kontabël të përdorur dhe vlerësimet e bëra lidhur me respektimin dhe zbatimin e rregulloreve dhe ligjeve gjatë zhvillimit të aktivitetit të OJQ “Shoqata e të Verbërve të Kosovës”.

”AlbAudit“, Ferizaj

Remzi Jashari, Auditor Ligjor

Shkurt, 2024



## 1. Informatat e përgjithshme

Organizata Joqeveritare “Shoqata e të Verbërve të Kosovës“ është regjistruar më datë 23.09.2003 me nr. 5102200-9, nr. fiskal 600167656 dhe me status të përfitimit publik nr. 6000842-6 në harmoni me qëllimet e organizatës, bazuar në kreun I, nenit 1 të ligjit Nr. 06/L- 43 mbi lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare. Selia e organizatës është në Prishtinë. “Shoqata e të Verbërve të Kosovës” është themeluar bazuar në rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/22 si dhe udhëzimin administrativ nr. 2000/10 mbi zbatimin e rregullores në fjalë dhe vazhdon të funksionoj me këtë status që është në përputhje me nenin 26 të ligjit 04/L- 57 te ndryshuar me ligjin 06/L-043.

Organizata ka statutin e vet të freskuar, adoptuar dhe aprovuar nga organet kompetente bazuar në ligj. Në këtë dokument janë të përshkruara në mënyrë të qartë misioni, vizioni i organizatës si dhe organet drejtuese dhe ekzekutive të Organizatës Joqeveritare “Shoqata e të Verbërve të Kosovës”. Organizata përbëhet dhe drejtohet nga organet sipas statutit.

Nga aktiviteti i organeve një qasje i është kushtuar punës së drejtimit i cili mban takime të rregullta në harmoni me statutin. Nga ekzaminimi i procesverbaleve nga takimet e drejtimit mund të shihet një punë e cila përshkohet me dëshmi lidhur me vendimet e rëndësishme të organizatës.

Gjithashtu organizimi i brendshëm i stafit është rregulluar nëpër ekipe të caktuara të cilat janë të ngarkuar për zhvillimin, udhëheqjen dhe menaxhimin e projekteve të caktuara siç janë, ekipi për hartimin e projekteve i cili ka adresuar projekte te donatorët duke garantuar financim për shoqatën në mënyrë që ajo të mund kryej detyrat e saj. Edukimi i personave të verbër dhe pjesëmarrja në aktivitete sportive, janë poashtu dy sektor të rëndësishëm në përfshirjen e personave të verbër, prandaj në dy nga artikujt në vazhdim janë paraqitur gjithë aktivitete e zhvilluara në këto dy fusha.

Përpilimin e pasqyrave financiare, OJQ- “Shoqata e të Verbërve të Kosovës” e bënë në harmoni me nenin 18 pika 6.1, 6.2 dhe nenin 6.9 të ligjit 06/L- 43. Raporti financiar është pjesa e III-të e raportit vjetor të Organizatës.

Organizata drejtohet nga menaxhmenti, ku përcaktohen dhe drejtohen politikat e organizatës në harmoni me rregullore e ligj.

Fokusi i misionit të OJQ “Shoqata e të Verbërve të Kosovës” është qenia njerëzore- të verbërit pa diskriminim fetar, etnik, social dhe racor duke vepruar në përputhje të plotë me statutin e organizatës. Gjatë periudhës e cila ishte objekt i auditimit, organizata joqeveritare “Shoqata e të Verbërve të Kosovës” me sukses zhvilloi një mori projektesh në lëmenj të ndryshëm në interes të verbërve, ndihmë njerëzve me nevoja, programe tjera etj.

## Bilanci i Gjendjes

	(EUR)
	Më 31 Dhjetor 2023
<b>Asetet</b>	
Paraja e gatshme dhe gjendja e arkës	19,471.11
Grantet e pranuar	-
Mjetet themelore, paisjet	21,283.84
Stoqet	-
<b>Gjithsej Asetet</b>	<b>40,754.95</b>
<b>Detyrimet dhe fondet</b>	
Detyrimet ndaj dhuruesve	19,471.11
Shpenzimet e përlogaritura	
Detyrimet tjera	
<b>Gjithsej Detyrimet</b>	<b>19,471.11</b>
<b>Fondet</b>	
Fondet e pashpenzuara 31 dhjetor 2023	30,209.80
Shtohen: Fondet e marrura në vitin aktual	124,255.95
Zvogëlohen: Fondet (shpenzuara) në vitin aktual	(133,181.91)
<b>Gjithsej fondet</b>	<b>21,283.84</b>
<b>Gjithsej fondet dhe detyrimet</b>	<b>40,754.95</b>

Prishtinë

Emine Prekaj Kuqi,

Daut Tishuki,

Shkurt, 2024

Menaxhere Financiare

Drejtor

## Pasqyra e të Ardhurave

(EUR)

Mbyllja e vitit  
31 Dhjetor 2023

### Të Ardhurat

Mjetet e pranuar, kontributet,  
dhuratat

124,255.95

**Gjithsej të Ardhurat****124,255.95****Shpenzimet e (Projektit)**

Shpenzimet e Programit

(119,870.03)

Menagjimi dhe administrimi

(7,990.92)

Shpenzimet tjera

(5,320.96)

**Gjithsej Shpenzimet****(133,181.91)****Neto mbetja/mungesa për  
periudhë****(8,925.96)**

Prishtinë

Shkurt, 2024

Emine Prekaj Kuqi,

Menaxhere Finaciare

Daut Tishuki,

Drejtor

## **2. Misioni i OJQ “Shoqata e të Verbërve të Kosovës “**

Qëllimet e Shoqatës janë harmonizimi i interesave të anëtarëve të saj, mbrojtja e interesave dhe të drejtave të verbërve në mënyrë të organizuar dhe publike, rritja e nivelit arsimor dhe profesional të të gjithë shtresës së të verbërve. Ngritja e interesimit të institucioneve, bizneseve të sektorit privat e publik për punësim duke u mbështetur në ligjet në fuqi, integrimi i të verbërve në shoqëri, edukimi i anëtarëve në frymën e vetëbesimit dhe të organizimit për dinjitetin dhe personalitetin e tyre. Kujdesi për kushtet e jetesës së të verbërve dhe ndërmjetësimi të strukturat ligjvënëse dhe ekzekutive për përmirësimin e saj. Shoqata senzibilizon opinionin lokal, kombëtar, ndërkombëtar, shoqëror dhe zyrtar në dobi të zgjedhjes së problemeve të të verbërve. Shoqate ofron shërbime të posaqme dhe të përgjithshme për të gjithë qytetarët e verbër drejtëpërdrejt ose nëpërmjet personave juridik të krijuar prej saj.

Në përputhje me këto nevoja promovon lëvizje, iniciativa, duke zhvilluar programe dhe projekte për të përmirësuar cilësinë e jetës, për zhvillimin dhe mbrojtjen e të drejtave të verbërve, duke përfshirë ndërtimin e afërsisë, arsimimin dhe kujdesin ndaj të verbërve në nevojë dhe të marginalizuar. Kjo organizatë përbënë nga ana tjetër një opus proprium, një detyrë që ajo e ka në objektiv, në të cilën ato nuk bashkëpunojnë anash, por vepron si subjekte drejtëpërdrejt të përgjegjshëm, duke bërë atë që i përgjigjet natyrës së tyre. Organizata nuk mund të shkarkohet kurrë prej ushtrimit të bamirësisë si veprimtari e organizuar e aktivistëve dhe, nga ana tjetër, nuk do të ketë kurrë një situatë në të cilën nuk do të nevojitet dashuria e çdo njeriu për njeriun, sepse njeriu, përtej drejtësisë, ka dhe do të ketë gjithmonë nevojë për dashuri, veprimi bamirësi mund e duhet të përqafojë me doemos të gjitha nevojat. Shoqata e të Verbërve të Kosovës ndan dashurine shpirtërore me të verbërit dhe njerëzit në nevojë, duke punuar së bashku për të promovuar solidaritetin, paqen dhe dashurinë. Epiqendra e misionit të organizatës është qenia njerëzore- të verbërit pa diskriminim fetar, etnik, social dhe racor duke vepruar në përputhje të plotë me statusin e organizatës.

## **3. Politikat e rëndësishme të kontabilitetit dhe bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

### **a) Bazat e përgatitjes dhe prezantimit**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me Standardet e Kontabilitetit të cilat aplikohen në Kosovë. Pasqyrat financiare janë të prezantuara në Euro. Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me konventën e kostos historike. Politikat e kontabilitetit janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme dhe përveç nëse ceket ndryshe, ato janë të njëjtat me politikat aplikuar në vitin paraprak. Periudha raportuese e organizatës është 12 muaj duke mbaruar më 31 Dhjetor të secilit vit. Pasqyrat Financiare janë përgatitur në baza krahasuese nga viti paraprak.



**b) Paraja dhe ekuivalentet e parasë**

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë bilancet e parasë së gatshme dhe ato të depozituara në bankat vendore.

**c) Prona, impiantet dhe pajimet**

Zërat e përfshirë në këtë kategori përfaqësojnë, pajisjet e zyrës dhe pajisje speciale për të verbërit si makina shkrimi Braille display 1, Braille display 4, pajisjet e teknologjisë informative, pajisje tjera të zyrës dhe njihen si asete vetëm kur është e mundur që:

- Aktivitetet e ardhshme të organizatës të lidhura me asetin do të rrjedhin dhe shërbejnë për Organizatën dhe
- kosto e asetit mund të matet me besueshmëri.

Asetet fillimisht regjistrohen sipas koston. Kostoja përfshinë të gjitha shpenzimet direkt të atribueshme në përvetësimin e zërit.

Organizata e mban asetet në kosto historike minus zhvlerësimi i akumuluar apo humbjet e akumuluar të dëmit, nëse ka. Zhvlerësimi i aseteve regjistrohet në baza vjetore duke përdorur metodën lineare dhe duke pas parasysh jetëgjatësinë e aseteve. Normat e aplikuara të zhvlerësimit janë të bazuara në ligjet e Republikës së Kosovës.

**d) Kontributet, ndihmat**

Mjetet e pranuar janë njohur vetëm kur ka siguri të arsyeshme se:

- Organizata do të përmbushë të gjitha kushtet dhe grantet do të pranohen

Grantet operative janë njohur si e hyrë përgjatë periudhës së nevojshme për ti lidhur ato me kostot, për të cilat janë menduar të kompensohen, në bazë sistematike. Grantet e shënuara për përvetësimin e pasurive janë shtyrë dhe njohur si e hyrë përgjatë kohës së përdorimit të pasurisë përkatëse.

**e) Llogarite e pagueshme**

Llogaritë e pagueshme janë njohur kur shuma është e përcaktueshme dhe obligimi për të shlyer shumën ekziston. Ato janë paraqitur në kosto.

**f) Shpenzimet**

Shpenzimet janë njohur atëherë kur kanë ndodhur.

**g) Tatimi në fitim**

Organizata është e liruar nga tatimi në fitim. Pasqyrat financiare janë përgatitur me qëllim të raportimit bazuar në dispozita ligjore si dhe për nevoja të menaxhimit të organizatës, me qëllim të marrjes së informacioneve për zhvillimin e aktivitetit më efikas që lidhet me fondet e pranuar për realizimin e objektivave të organizatës. Këto pasqyra financiare përfshijnë të gjitha shpenzimet e krijuara, të cilat janë të financuara nga donatorët dhe dhuruesit të cilët tash janë partner të besueshem të OJQ " Shoqata e të Verbërve të Kosovës" me seli në Prishtinë.

#### 4. Aktivitete dhe Projektet e SHVK të realizuara gjatë vitit 2023

Aktivitete kryesore që Shoqata e të Verbërve të Kosovës i ka zhvilluar gjatë periudhës Janar –Dhjetor 2023 ishin, në fushën e avokimit, arsimit, shëndetësisë, mirëqenjes sociale dhe rehabilitimit për personat e verbër, gjithashtu edhe me aktivitete sportive e kulturore. Periudha ka qenë e ngjeshur më një aktivitet intensiv, duke lobuar vazhdimisht për zbatimin e legjislacionit, krijimin e kushteve për personat e verbër, përmirësimin e gjendjes dhe arritjen e përfitimeve që atyre ua njeh Ligji për personat e verbër dhe ligjet tjera. Shoqata në këtë përpjekje të vazhdueshme ka mbështetjen e disa donatorëve, të cilet e kanë perkrahur dhe qëndruar perkrah dhe kanë mundësuar që anëtarësia të përfitojë dhe të përmirësojë kushtet e jetës dhe pavarësimin e vazhdueshëm. Përkushtimi në misionin e shoqatës, puna e përgjegjshme, bashkëpunimi dhe krijimi i partneriteteve ka qenë e rëndësishme për SHVK-në edhe në këtë periudhë. Është një kohë kur edhe vet SHVK ka zgjerruar kapacitetet e saj, plotësuar me dy rregullore të rëndësishme në funksionimin e saj, rregulloren për barazi gjinore dhe Rregulloren për procedurat e prokurimit, për të cilat edhe është trajnuar stafi.

Ekipi për hartimin e projekteve ka adresuar projekte te donatorët duke garantuar financim për shoqatën në mënyrë që ajo të mund kryej detyrat e saj. Projektet e zbatuara në këtë periudhë kanë të bëjnë me rritjen e kapaciteteve të shoqatës dhe profesionalizimin e shërbimeve që ajo ofron në komunitet, mbrojtjen e të drejtave të personave të verbër, avokimi për zbatimin e ligjit lidhur me punësimin, pajisjen me mjete tiflo teknike dhe tiflo didaktike, pjesëmarrjen e personave të verbër në aktivitete kulturore, nxitja e krijimtarisë dhe njohja me trashëgiminë kulturore dhe multi etnike të Kosovës, ngritjen e kapaciteteve të kuadrit arsimor që punon me personat me aftësi të kufizuara, etj. Edukimi i personave të verbër dhe pjesëmarrja në aktivitete sportive, janë poashtu dy sektor të rëndësishëm në përfshirjen e personave të verbër, prandaj në dy nga artikujt në vazhdim janë paraqitur gjithë aktivitete e zhvilluara në këto dy fusha.

Anëtarët ishin të kënaqur që këto arritje dhe angazhime kanë paraqitur në mënyrë të hollësishme dhe kronologjike. Kjo i shërben jo vetëm informimit, por edhe rritjes së transparencës së punës së shoqatës të të verbërve të Kosovës.

Në përkushtimin e saj për të perkrahur Personat me Aftësi të Kufizuara në Kosovë, Qeveria e Kosovës ka vazhduar me perkrahjen e personave me Aftësi të Kufizuara. "Kalendari i aktiviteteve për vitin 2023", është hartuar me kontributin e Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuara (HandiKOS); Shoqata Kosovare e të Shurdhërve; Shoqata Kosovare e të Verbërve; Syndrome Doën Kosova; Autizmi; dhe Forumi i Kosovar për Aftësinë e Kufizuar dhe përfaqësuesve të ministrive përkatëse (Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve; Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministria e Drejtësisë dhe Policia e Kosovës). Ky raport ofron një pasqyrë të progresit dhe arritjeve të zbatimit të "Kalendarit të Aktiviteteve 2023" për periudha të

caktuara, por ëshë jo përfudnimtar psai një pjesë e aktivteteve të tremujorit të fundit nuk janë raportuar. Gjatë kësaj periduhe Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit (ZQM/ZKM) si dhe ekipi i projektit “Kosova Gjithëpërfshirëse” ishin funksionale gjatë gjithë periudhës raportuese duke i ofruar mbështetje OPAK dhe Ministrive relevante në mënyrë që të njëjtit të bashkëpunojnë dhe koordinojnë veprimet e tyre lidhur me zbatimin e aktiviteteve të “Kalendarit 2023”.

Rezultatet sipas raportit te progresit nuk janë shumë të kënaqshme, mirëpo ka pasur nisma ne të gjitha fushat.

#### 5. Shërbimet e ofruara gjatë viti 2023

Shoqata e të Verbërve të Kosovës e cila ka shtrirje gjeografike në tërë Republikën e Kosovës me degët e saj Ndërkomunale dhe Komunale, në kuadër të implementimi të projekteve të ndryshme ka ofruar shërbime të nevojshme për komunitetin e saj në: Orientim e Mobilitet dhe shkathtësi Ditore, Shkrim lexim në Braille, Teknologji Informative Asistuese për të Verbër dhe shërbime psiko sociale. Ndërsa shërbime administrative sipas nevojave te paraqituara.Shërbimet janë ofruar në të gjitha qendrat, pra përmes degëve, sipas kërkesave dhe nevojave të anëtarëve.

SHVK ka pasur bashkëpunime me shumë institucione të R.Kosovës në nivel qendror dhe lokal. Me Qeverinë e Republikës së Kosovës saktësisht me Zyrën për Qeverisjes së Mirë/Zyra e Kryeministrit, me Kuvendin, Zyrën e Presidencës me ministrinë dhe me departamente të ndryshme. Bashkëpunim më i vecant ka qenë më departamentin e pensionove pranë Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve, me qëllim të ri funksionalizimit të komisioni shtetëror mediko Social, pasi qe i njejt ka pasur pauza të herë pas hershme. Bashkëpunime ka pasur edhe me ministrinë e arsimit, për realizimin e objektivës së SHVK-së e cila ka për qëllim krijimin dhe zhvillimin e Sintezës Vokale në Gjuhën Shqipe, mirëpo ndonjë hap konkret nuk është ndërmarr deri me tani.Bashkëpunime ka pasur edhe me Qendren Burimore për Mësim.

#### 6. Projektet kryesore të SHVK janar- dhjetor 2023 janë përshkruar më poshtë:

Në këtë periudhë shoqata e të verbërve të Kosovës ka pasur një aktivitet të ngjeshur në lobim, avokim dhe në përmirësimin e kushteve të jetës dhe pavarësimit të komunitetit të personave të verbër në Kosovë. Aktivitetet e shoqatës janë mbështetur nga projektet ekzistuese me donatorë si dhe aktivitete nga obligimet që dalin nga misioni i shoqatës.

Gjatë këtij viti kanë qenë në implementim disa projekte të mbështetura nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSE) ‘EJA Kosovë’, Presidenca e Republikës së Kosovës, MASHT-i, Save the Children, Unioni evropian i të verbërve, CDF, MKRS, Komisioni Evropian ne bashkëpunim me Handikos dhe Swiss Coporation.

**Tabela 1. Mjetet e pranuar dhe shpenzuara sipas projekteve- Gjendja financiare e projekteve-2023**

Emertimi i proj.	Gjendja ne fillim	Te ardhurat	Shpenzimet	Gjendja ne fund
ATRC	0.00	9,881.00	9,881.00	0.00
K2.0	0.00	4,399.20	5,815.74	-1,416.54
KCSF2	1,569.39	30,000.00	31,030.72	538.67
EBU	-2,315.00	2,315.00	0.00	0.00
MKRS-2024	0	22,000.00	0.00	22,000.00
MD	0.00	26,000.00	26,000.00	0
CDF	-1,000.00	1,000.00	0.00	0.00
MPMS2022-23	<b>8,000.00</b>	0.00	8,000.00	0
MKRS2	707.76	-707.76	0.00	0.00
MKRSTurki	0	7,190.00	6,789.07	400.93
Presidenca	0.00	4,000.00	0.00	4,000.00
MKRSEKOSOVA	14,400.21	0	14,400.21	0
EU	0.00	4,643.59	10,453.09	-5,809.50
Tjera			242.45	-242.45
	<b>21,362.36</b>	<b>110,721.03</b>	<b>112,612.28</b>	<b>19,471.11</b>

### 7. Pasuritë dhe detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet

Në gjendjen e datës 31 Dhjetor 2023 pasuritë e organizatës joqeveritare "Shoqata e të Verbërve të Kosovës" ishin mjetet monetare, pajisjet e inventarët e nevojshëm për zhvillim të aktivitetit. Vlera neto e prezantuar e pasurive reflekton se këto pasuri janë amortizuar në një masë gjatë viteve të aktivitetit, në harmoni me kërkesa ligjore. Këto mjete, fizikisht janë funksionale dhe përmbushin nevojat dhe kërkesat.

Vërehet një ndryshim i vlerës furnizuese të mjeteve themelore në krahasim me vitin e kaluar shkak i zhvlerësimit të vitit, ndërsa ka pasur edhe furnizime te reja. Mjetet themelore të prezantuara në pasqyrat financiare kanë mbështetje të plotë në regjistra dhe evidenca kontabël. Jemi të mendimit se regjistrat e mjeteve themelore janë të qartë dhe mirëmbahen sipas kërkesave ligjore.

Nga ekzaminimet e kryera gjatë auditimit kemi konstatuar se kjo organizatë joqeveritare, pasi që evidencat i bazon në ligjin mbi asocimin ne organizata joqeveritare si dhe ne ligjet dhe rregullat fiskale te republikes se Kosoves. Bazuar ne dispozitat e permendura të ardhurat janë njohur me rastin e shpenzimit gjegjësisht me rastin e implementimit të projekteve të caktuara. Me rastin e pranimit të parasë, shkak i statusit jo profitabil dhe të përfitimit publik, "Shoqata e të Verbërve të Kosovës" së pari ka njohur detyrimin ndaj dhuruesit (si e ardhur e pafitur) të cilin veprim e konsiderojmë të drejtë dhe në harmoi me dispozitat ligjore. Këto të ardhura janë fituar bazuar në projektet e përgatitura nga "Shoqata e të Verbërve të Kosovës". Shpenzimet janë njohur atëherë kur kanë ndodhur, sipas parimit kohor. Në përgjithësi jemi të mendimit se njohja e të ardhurave dhe e

shpenzimeve është bërë në harmoni me standarde dhe rregullore. Gjatë këtij viti krahasuar me vitin paraprak pagat të cilat janë raportuar kanë shënuar një lëvizje dhe kapin vlerë bruto 64,222.36Euro. Kjo shumë ka të bëjë me realizimin e programeve dhe menaxhim e administrim. Në këtë organizatë pjesëmarrja e të ardhurave individuale në shpenzimet e përgjithshme është reale dhe përkon me misionin e kësaj organizate.

Sa i përket mënyrës së përlllogaritjes dhe pagesës së të ardhurave individuale, jemi të mendimit se në tërësi është respektuar ligji 05/L-028 mbi tatimin në të ardhura individuale në Kosovë. Transferimi i pagave është bërë nëpër llogari bankare. Tatimi i mbajtur në burim është përlllogaritur në mënyrë të rregullt dhe është paguar në afatet ligjore. Këto procedura janë aplikuar poashtu edhe me rastin e përlllogaritjes dhe pagesës së mjeteve të trustit për kursime pensionale.

**Tabela 2. Mjetet e pranura dhe dalura sipas llogarive**

<u>Burimi i mjeteve sipas llogarive</u>			<u>Përmbyllja e vitit</u>	
			<b>31 Dhjetor 2023</b>	
	<u>Gjendja fi.</u>	<u>Dalja e parase</u>	<u>Hyrja e par.</u>	<u>Gjendja ne fund</u>
1701001010397125	44.98	11,496.80	11,465.30	13.48
1701016900011066	2,357.29	31,470.32	30,000.00	886.97
1700200100159738	15,613.96	128,665.09	131,620.33	18,569.20
Tjera	-	-	-	-
<b>Totali</b>	<b>18,016.23</b>	<b>171,632.21</b>	<b>173,085.63</b>	<b>19,469.65</b>

**Tabela 3. Paraja në fund të periudhës**

Më 31 Dhjetor 2023 paraja në krahasim me periudhën e kaluar shënon një gjendje e cila është më e madhe se në periudhën paraprake. Mjetet nga gjendja e datës 31 Dhjetor të periudhës së kaluar janë shfrytëzuar për projektet për të cilat ishin zotuar dhe kishin rrjedhur në llogaritë e “” Shoqata e të Verbërve të Kosovës” deri në atë kohë.

Më 31 Dhjetor 2023

<b>Llogaritë në Banka Lokale</b>	
NLB – Bank, Prishtinë	19,469.65
<b>Paraja dhe ekuivalentët</b>	<b>19,469.65</b>
<b>Paraja e gatshme dhe gjendja në arkë</b>	
Paraja e gatshme në arkë	1.46
<b>Paraja dhe gjendja e arkës</b>	<b>1.46</b>
<b>Total paraja</b>	<b>19,471.11</b>

**Tabela 4. Gjendja e mjeteve themelore**

Më 31 Dhjetor 2023 lista e mjeteve të OJQ-së përfshinë të gjitha pajisjet për aktivitete operative. Tabela në vijim ofron të dhënat për lëvizjet në kosto dhe amortizimin e akumuluar për periudhën në shqyrtim.

	Kostoja	Zhvlersimi i Akumuluar	Vlera neto e paisjeve
<b>Më 01 Janar 2022</b>	<b>43,041.00</b>	<b>(16,436.20)</b>	<b>26,604.80</b>
Blerjet gjate 2022	-	-	-
Amortizimi i vitit 2022		(5,320.96)	(5,320.96)
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2022</b>	<b>43,041.00</b>	<b>(21,757.16)</b>	<b>21,283.84</b>

**Organizimi i brendshëm dhe procedurat e “Shoqata e të Verbërve të Kosovës”**

OJQ-“” Shoqata e të Verbërve të Kosovës”, aktivitetin e vet financiar e ka zhvilluar bazuar në procedurat e brendshme financiare të cilat mbështeten në ligje dhe rregullore në fuqi të cilat aplikohen në Kosovë. Nga analiza dhe ekzaminimi i bërë procedurave në fjalë, ne kemi konstatuar se në këto procedura janë definuar detyrimet si dhe autorizimet e zyrtarëve të angazhuar me punë. Procedurat e brendshme të cilat janë hartuar nga “Shoqata e të Verbërve të Kosovës” dhe janë rishikuar dhe aprovuar nga zyrtarët e organizatës janë në harmoni të plotë me ligje dhe rregullore të Kosovës të cilat lidhen me funksionimin dhe lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare Nr.06/L- 43, ligji mbi të

ardhura individuale dhe në Kosovë etj. Ndër procedurat të cilat aplikohen në organizatë janë procedurat e buxhetimit të bazuara në procedura dhe rregulla financiare. Nga dokumentacioni mund të vërehet se funksioni i krijimit të dokumentit financiar si dhe aprovimi dhe ekzekutimi janë ndarë, që është në përputhje me kërkesat e standardeve dhe procedurave të operimeve financiare. Gjithashtu qartë është përshkruar kufiri dhe niveli i përgjegjësive dhe autorizimeve në menaxhimin e financave, sipas nivelit dhe pozitës së zyrtarëve. Në realizimin e procedurave financiare dhe të rrjedhës së parasë mund të shihet lëvizja e dokumenteve financiare prej momentit të parashtrimit të kërkesës për mjete financiare deri në momentin e aprovimit për pagesë dhe shpenzimit definitiv të këtyre mjeteve. Po ashtu kemi konstatuar se raportimi ndaj donatorëve dhe dhuruesve të ndryshëm është kryer sipas standardeve dhe kontratave mbi dhurimin.

Përpilimin e pasqyrave financiare, OJQ " Shoqata e të Verbërve të Kosovës" e bënë në harmoni me nenin 18.1 të ligjit 06/L-57 respektivisht nenit 18 pika 6.1. 6.2. dhe 9 i ndryshuar me ligjin 06/L-043. Raporti financiar është pjesa e III-të e raportit vjetor të organizatës në harmoni me nenin 18.3.3. të ligjit për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare.

Procedurat financiare dhe rrjedhën e dokumentacionit dhe të parasë e kemi ekzaminuar në tërësi dhe jemi bindur në mbylljen e ciklit financiar.

## **8. Përfundimi**

Me kompetencë dhe siguri të arsyeshme mund të konstatojmë se kemi të bëjmë me evidenca të kompletuara dhe se ekziston një saktësi e mjaftueshme në evidenca dhe pasqyra financiare. Nuk kemi vërejtur ndonjë gabim të nivelit material, ndonjë mashtrim apo tentim mashtrimi. Gjatë sigurimit të dokumentacionit nuk kemi pasur ndonjë pengesë për ta bërë këtë. Shprehim respektin tonë ndaj personelit për asistencën e ofruar. Auditimin e kemi planifikuar, dhe programin e auditimit e kemi realizuar sipas dinamikës së paraparë.